



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE DHE TRANSPORTEVE
UJESJEDHES-KANALIZIME SH.A MALESI E MADHE
KESHILLI MBIKEQYRES

Adresa: Koplik, Malesi e Madhe

Nr 01. Prot.

Koplik me: 25.04.2010

VENDIM:
Nr: 01, Dt: 25.04.2010

Ne mbeshetjetje te ligjit nr: 7296, dt: 20.04.1995 "per transferimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare" I ndryshuar si edhe ne baze te V.K.M Nr:678, dt: 03.10.2007 "per nje shtese ne vendimin nr: 271, dt: 09.05.1998 te Keshillit Ministrave "Per miratimin e statutit tip te shoqerive anonime shteterore" Neni 20 dhe 21 , pika 1, pasi shqyrtoi gjendjen e rende te krijuar ne kete ndermarrje, me votim (e cilesuar sipas ligjit).

VENDOSI:

1. Te shkarkoj nga detyra e drejtotit te ndermarrjes(Ujsjelles Kanalizime sh.a) M. Madhe z Ramadan Tahiri
2. Ky urdher hyne ne fuqi menjehere

Per KESHILLIN MBIKEQYRES:

Sekretari:
Gasper Deda

Kryetari:
Asim Burgaj

Anetare:

1. Islam Semanaj
2. Palok Vrucaj
3. Zef Lelcaj
4. Fadil Zekaj



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE DHE TRANSPORTEVE
UJESJEDHES-KANALIZIME SH.A MALESI E MADHE
KESHILLI MBIKEQYRES

Adresa: Koplik, Malesi e Madhe

Nr 02. Prot.

Koplik me: 25.04.2010

VENDIM:
Nr: 01, Dt: 25.04.2010

Ne mbeshetjetje te ligjit nr: 7296, dt: 20.04.1995 "per transferimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare" I ndryshuar si edhe ne baze te V.K.M Nr:678, dt: 03.10.2007 "per nje shtese ne vendimin nr: 271, dt: 09.05.1998 te Keshillit Ministrave "Per miratimin e statutit tip te shoqerive anonime shteterore" Neni 20 dhe 21 , pika 1, pasi shqyrtoi gjendjen e rende te krijuar ne kete ndermarrje, me votim (e cilesuar sipas ligjit).

VENDOSI:

1. Te emerjoj ne detyren e drejtotit te ndermarrjes(Ujsjelles Kanalizime sh.a) M. Madhe z Ismet Balaj
2. Ky urdher hyne ne fuqi menjehere

Per KESHILLIN MBIKEQYRES:

Sekretari:
Gasper Deda

Kryetari:
Asim Burgaj

Anetare:

1. Islam Semanaj
2. Palok Vrucaj
3. Zef Lelcaj
4. Fadil Zekaj



VENDIM

NR. 05. DATE 15.08.2011

Ne mbështetje të ligjit nr. 7296 date 20.04.1995 "Per transformimin e Ndermarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare" i ndryshuar si dhe në baze të vendimit të Keshillit Mbikqyres nr. 678 date 03.10.2007 "Per një shtese në vendimin nr.271 date 09.05.1998 të Keshillit të Ministrave" ("Per miratimin e statutit tip të shoqërive anonime shqiptare") nëni 20 dhe 21 pika 1, pasi shqyrtoi gjendjen e rende të krijuar në këte ndermarrje dhe me votim të cilesuar (sipas ligjit):

VENDOSI

1. Të shkarkohe nga detyra e drejtorit të Ndermarrjes "Ujesjelles – Kanalizime sh.a" Malesi e Madhe z. **ISMET TAFIL BALA**.
2. Ky urdher hyn në fuqi menjëherë.

PER KESHILLIN MBIKQYRES

1. Gasper Deda
2. Zef Lelcaj
3. _____

SEKRETARI

N/KRYETARI

KRYETARI

Gasper DEDA

Islam SEMANAJ

Asim BURGAI

Monday, August 15, 2011

DHOMA E NOTEREVE SHKODER

Noter Sabri M Kurtaj

Zyra e Noterise KOPLIK

Nr. 714 Repertori .Nr. 359 Koleksioni
Cmimi 2500 TVSH 500 leke Pajisje takse 200 leke (arshiva)

Mob.00355682126019

Tel/Fax 003552112385

Vertetim nenshkrimi .

(Bazuar në nenin 55 i ligjit n.7829 date 01.06.1994)

Sot me datën **15.08.2011** (pesëmbëdhjetë gusht dymijënjëmbëdhjetë) në zyren e noterise Koplík dhe para meje noter i zyrës Sabri M.Kurtaj u paraqiten personalisht shtetasit:

Palok Vucaj i biri i Lulash-it dhe Lules i datelindjes 05.02.1968 lindur në Shkoder e banues në Shkrel komuna Shkrekl i identifikuar nrm ID nr 025533592

Zef Lelcaj i biri i Martin-it dhe Diell-es i datelindjes 18.03.1961 lindur në Shkoder e banues në Tamare komuna Kelmend i identifikuar nrm ID 025227808

Gasper Deda i biri i Rrok-ut dhe Mrike-s i datelindjes 30.05.1962 lindur në Shkoder e banues në Bajze i identifikuar nrm njohjes personale

Islam Semanaj i biri i Zenel-it dhe Life-s i datelindjes 16.02.1953 lindur në Shkoder e banues në Koplík i identifikuar nrm ID 026246679

Asim Burgaj i biri i Zenel-it dhe Hanes i datelindjes 26.03.1967 lindur në Shkoder e banues në Balshaj komuna Gruemire i identifikuar nrm 028242149

Per identitetin e të cileve u sigurova nga sa me sipër, dhe pasi konstatova se i kanë të gjitha aftësitë e kerkuara ligjore, madhor e me zotësi të plote juridike për të vepruar, me kerkesën e tyre për të u vertetuar nenshkrimin e vëne në dokumentin bashkëngjitur ketij autentifikimi, (Vendim Nr 5 dt 15.08.2011, i Keshillit Mbikqyres Ujesjelles Kanalizime sh.a. Malesi e Madhe) pasi deklaruan në praninë time se nenshkrimet në dokumentin bashkëngjitur janë të tyre personal, unë noteriu bazuar në ligjin "Per Noterine" Nr 7829 date 01.06.1994, iu vertetoi nenshkrimet ...

Noter

Sabri M. Kurtaj

Leje Profesionale nr 1872
NIPT K37907725M

VENDIM

NR. 06. DATE 15.08.2011

Ne mbështetje të ligjit nr. 7296 date 20.04.1995 "Per transformimin e Ndermarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare" i ndryshuar si dhe në baze të vendimit të Keshillit Mbikqyres nr. 678 date 03.10.2007 "Per një shtese në vendimin nr.271 date 09.05.1998 të Keshillit të Ministrave" ("Per miratimin e statutit tip të shoqërive anonime shqiptare") nëni 20 dhe 21 pika 1, pasi shqyrtoi gjendjen e rende të krijuar në këte ndermarrje dhe me votim të cilesuar (sipas ligjit):

VENDOSI

1. Të emerohe në detyrën e Drejtorit të Ndermarrjes "Ujesjelles – Kanalizime sh.a" Malesi e Madhe z. **HAJRULLAH SHAQIR GJEKAJ**.
2. Ky urdher hyn në fuqi menjëherë.

PER KESHILLIN MBIKQYRES

1. Gasper Deda
2. Zef Lelcaj
3. _____

SEKRETARI

N/KRYETARI

KRYETARI

Gasper DEDA

Islam SEMANAJ

Asim BURGAI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
UJESJELLES KANALIZIME MALESI E MADHE SH.A.

Nr. 2828 Prot.

Shkoder , me: 07/07/2017

VENDIM

Nr. 88 , date 07/07/2017

**PËR
EMERIMIN E ADMINISTRATORIT TË
UJESJELLES KANALIZIME MALESI E MADHE SH.A.**

Në mbeshtetje të ligjit Nr. 139/2015 “ Per Vetqeverisjen Vendore “, Ligjit nr. 9901 datë 14/04/2008 “ Për tregtarët dhe shoqërite tregtare“ , të ndryshuar, VKM nr. 63 datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin , largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura“, Statutit të Ndërmarrjes Sh.A Ujësjiellës Malësi e Madhe, Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme,

VENDOSI:

1. Të emërojë z. Ndoc Prela, me nr. Personal: G80210189U, si Administrator i Ujësjiellës Kanalizime Malësi e Madhe sh.a.,
2. Paga e administratorit do të jetë 80.000 (tetëdhjetëmijë) Lek.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen strukturat përgjegjëse të administratës Ujësjiellës kanalizime Malësi e Madhe sh.a.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME

TONIN MARIQAJ



Adresa: Linaj – Gruemire - Rezervuari 4000 m3 - Malesi e Madhe



QNR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
UJESJELLES KANALIZIME MALESI E MADHE SH.A.

Nr. 2322/1 Prot.

Shkoder, me 07/07/2017

VENDIM
(I BRENDSEM)

PËR
PRANIMIN E DOREHEQJES DHE LIRIMIN NGA DETYRA E ADMINISTRATORIT
TË
UJESJELLES KANALIZIME MALESI E MADHE SH.A.

Në mbështetje të ligjit nr. 9901 datë 14/04/2008 " Për tregtarët dhe shoqërite tregtare" , të ndryshuar, VKM nr. 63 datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin , largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura", Statutit të Ndërmarrjes Sh.A Ujësjetllës Malësi e Madhe, ,Doreheqjes Nr. 285 prot, date 07.07.2017 te z. Flauers Shoshi, Asambleja e Përgjithshme,

VENDOSI:

1. Pranimin e doreheqjes dhe lirimin nga detyra të Administratorit të Ujësjetllës kanalizime Malësi e Madhe sh.a., z. Flauers Shoshi.
2. Ngarkohen strukturat përgjegjëse të administratës Ujësjetllës kanalizime Malësi e Madhe sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME

TONIN MARINAJ



Adresa: Linaj – Gruemire - Rezervuari 4000 m3 - Malesi e Madhe



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MALESI E MADHE



V E N D I M

Lënda: Miratimi I Statutit të Ujësellsit Malësi e Madhe
Nr. 2038 Prot me dt 27 / 07 / 2016

Sot me date 27/07 / 2016 u vendos miratimi I Statutit të Ujësellsit Malësi e Madhe me ndryshimet përkatëse.

KRYETARI I ASAMBLESE

z. TONIN MARINAJ



№. 2038 Prot.

Dt. 27/07/16



STATUT I SHOQËRISË AKSIONARE

“Ujësjetës Malesi e Madhe”



Në këtë statut:

-“Ligji“ është Ligji nr.9901 datë 14.04.2008“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare“, i ndryshuar;-
“Statuti“ është statuti i shoqërisë;

-“Aksionarët“ janë personat të cilët emrat e tyre janë regjistruar në regjistrin e aksioneve të shoqërisë si zotërues të aksioneve;

-“Ditë të plota“ në lidhje me periudhën e një njoftimi është periudha që nuk e përfshin ditën kur është dhënë ose kur konsiderohet se është dhënë njoftimi dhe ditën për të cilën është dhënë ose hyn në fuqi njoftimi;

-“Shoqëria“ është Ujësjiellës Malesi e Madhe sh.a.

Neni 1

Emërtimi dhe selia

1. Shoqëria aksionare ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me zonën e juridiksionit të Bashkisë Malesi e Madhe.
2. Shoqëria e krijuar në këtë mënyrë emërohet Ujësjiellës-Kanalizime Malesi e Madhe sh.a.
3. Selia e shoqërisë është në adresën Lgj: Gruemire, Rrezervuari 4000 m3 ne Njesine Administrative Gruemire, Malesi e Madhe.

Neni 2

Objekti

1. Objekti i shoqërisë brenda territorit të Bashkisë Malesi e Madhe së krijuar sipas ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, është:
 - a. Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij;
 - b. Mirëmbajtja e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm;
 - c. Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve;
 - d. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura;
2. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarisë dhe krijimin e shoqërive të reja si dhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive të tjera jashta vendit.
3. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me lejet, autorizimet, licencat sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 3

Kohezgjatja e veprimtarisë

1. Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar.
2. Aksionarët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe me pas zgjatjen e saj një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

Neni 4
Kapitali

1. Kapitali fillestar i shoqërisë është në vlerën 32 420 000 ,000 (tridhjetë e dymilion e katerqind e njezet mije) Lekë.
2. Kapitali i shoqërisë është nënshkruar tërësisht.

Neni 5
Aksionet e shoqërisë

1. Aksionet janë të formës nominative dhe pronësia mbi to është e patjetërsueshme, me përjashtim të rasteve kur e drejta e pronësisë i kalon një organi të qeverisjes vendore.
2. Pronësia mbi aksionet rezulton nga regjistrimi i tyre në emër të titullarit në librin e aksioneve të mbajtura nga ana e shoqërisë.
3. Kapitali themeltar është 32 420 000 leke e ndare në 32 420 aksione me vlerë nominale 1000 lek.
4. Aksionari i vetëm i Ujesjellës Malesi e Madhe sh.a. është Bashkia Malesi e Madhe me 100 % të aksioneve

Neni 6
Kërkesat për të paguar aksionet dhe tërheqja e aksioneve të papaguara

1. Administratorët mund t'u kërkojnë aksionarëve pagimin e kontributeve të pashlyera në lidhje me aksionet e tyre dhe çdo aksionar (pas marrjes së njoftimit prej 14 ditësh të plota në të cilin përcaktohet koha dhe vendi i kryerjes së pagesës) i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për aksionet e zotëruara. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me këste të kontributeve të papaguara. Personi të cilit i drejtohet njoftimi për pagesën e kontributit do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtohen atij pavarësisht kalimit të mëposhëm të pronësisë së aksioneve me të cilat lidhet njoftimi përpagesë.
2. Zotëruesit e përbashkët të një aksioni do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe në mënyrë solidare për shlyerjen e kontributeve sipas njoftimit të mësipërm.
3. Në rast se pas njoftimit përshlyerjen e kontributeve pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, personi përgjegjës për shlyerjen e kontributeve do të paguajë një interes mbi shumën e papaguar me një kamatë vonesë prej 4% në vit duke filluar nga dita e parashikuar për pagesën.
4. Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve, pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, Administratorët mund të njoftojnë paraprakisht të paktën tridhjetë ditë të plota, personin përgjegjës për shlyerjen e kontributeve, duke i kërkuar pagesën e shumës së pashlyer së bashku me shumën e mundshme shtesë të kamat vonesës. Njoftimi do të përmbajë vendin ku duhet të kryhet pagesa dhe deklarin se në rast moszbatimi të tij, pasojat ligjore do të jenë ato të parashikuara në pikën 2 dhe 3 të nenit 124 të Ligjit.

5. Nëse pagesa nuk kryhet brenda afatit të parashikuar në pikën 3 të nenit 124 të Ligjit, aksioni me të cilin lidhet njoftimi mund të anulohet me vendimin e Administratorëve dhe anulimi do të përfshijë të gjithë dividendët ose shumat e tjera të pagueshme në lidhje me aksionet e anuluar dhe të pa paguara deri në momentin e anulimit.
6. Anulimi i aksionit sjell zvogëlimin e kapitalit themeltar të Shoqërisë në përputhje me parashikimin e nenit 186 të Ligjit.
7. Personi, aksionet e të cilit janë anuluar, humbet cilësinë e aksionarit lidhur me këto aksione por do të jetë përgjegjës ndaj Shoqërisë për të gjitha kontributet që do të shlyheshin nga ky aksionar ndaj Shoqërisë në datën e anulimit të aksioneve së bashku me kamatë vonesën e llogaritur për këto contribute për para anulimit të aksioneve.

Neni 7

Llojet e Aksioneve, Obligacionet, të Drejtave dhe Kufizimeve

1. Në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga aksionet ekzistuese, aksionet e reja mund të emtohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të marre me shumicën e kualifikuar (tre të katërtat) të votave të aksionarëve.
2. Asambleja e përgjithshme me të njëjtën shumicë të kualifikuar votash, mund të vendosë emetimin e obligacioneve të cilat u garantojnë zotëruesve të tyre të drejtën për t'i kthyer në aksione ose të drejtën e parablerjes për aksionet (obligacionet e kthyeshme) dhe obligacionet që bëjnë të mundur pjesëmarrjen e zotëruesve të tyre në ndarjen e fitimeve në dobi të aksionarëve (obligacionet mepjesëmarrjenë fitim).

Neni 8

Çertifikatat e aksioneve

1. Secili aksionar që zotëron aksione ka të drejtë të përfitojë një çertifikatë për të gjitha aksionet e çdo klase të zotëruara nga ai. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një çertifikatë për aksionet e zotëruara bashkërisht ngadisapersonadhedorëzimi i çertifikatës ndaj përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët të aksioneve do të konsiderohet si dorëzim i kryer ndaj të gjithë zotëruesve të aksioneve, në përputhje me pikën 1 të nenit 121 të Ligjit. Emrat e zotëruesve të përbashkët të aksioneve do të renditen në çertifikatën e aksionit. Në këtë rast zbatohen dispozitat e pikës 2 të nenit 117 të Ligjit.

Neni 9

Regjistri i aksioneve

1. Pronesia e aksioneve vërtetohet nga regjistrimi i tyre në emër të pronarëve në regjistrin e mbajtur për këtë qëllim nga shoqëria, sipas mënyrës të parashikuar me ligj.
2. Administratori i shoqërisë është përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të aksioneve sipas ligjit.

Neni 10
Zmadhimi i kapitalit themeltar

1. Kapitali themeltar i shoqërisë mund të zmadhohet sipas menyrave dhe rregullave të parashikuara në nenet 168 deri 180 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", I ndryshuar. Me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 176 të Ligjit të mesipër, zmadhimi i kapitalit themeltar mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme e cila vendos me tre të katërtat e votive të aksionarëve që zotërojnë me shumicë të gjysmës së numrit total të aksioneve me të drejtë vote apo përfaqësuesit e tyre, të cilët marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike.
2. Kapitali themeltar nuk mund të zmadhohet nëse nuk janë shlyer ende kontributet për aksionet e nënshkruara me pare.
3. Administratori është i detyruar të njoftojë për regjistrim, pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit, vendimin për zmadhimin e kapitalit.

Neni 11
Zvogelimi i kapitalit themeltar

1. Zvogelimi i kapitalit themeltar të Shoqërisë kryhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme në pajtim me dispozitat e nenëve 181 deri 186. Zvogelimi i kapitalit realizohet nëpërmjet zvogelimit të vlerës nominale të aksioneve.
2. Zvogelimi i kapitalit nuk duhet të cenojë raportin e aksionarit para këtij zvogelimit. Kapitali nuk mund të zvogelohet nën shumën minimale të kërkuar nga ligji.

Neni 12
Kalimi me kontratë i aksioneve

1. Kontrata e kalimit të aksionit bëhet me shkrim dhe sipas formaliteteve të përcaktuara nga Administratori përgjegjës për mbajtjen e regjistrimit të aksioneve të Shoqërisë dhe do të zbatohet nga dhe për llogari të personit që kalon aksionet ose nga personi i autorizuar prej tij dhe nga e për llogari të personit të cilit i kalohen aksionet ose nga personi i autorizuar prej tij, nëpërmjet regjistrimit në regjistrin e aksioneve të shoqërisë në përputhje me nenin 119 të Ligjit.

Neni 13
Emetimi i aksioneve të reja

1. Kur emetohen aksione të reja, këto aksione iu ofrohen aksionarëve ekzistues përpara se t'u ofrohen aksionarëve të tjerë të rinj, në pajtim me nenin 174 të Ligjit. Aksionet e reja iu ofrohen aksionarëve sipas numrit të aksioneve që zotërojnë përpara ofertës. Oferta që iu bëhet aksionarëve ekzistues duhet të pranohet brenda 20 (njëzet) ditësh.

2. Aksionet të cilat, në momentin e miratimit të vendimit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, nuk janë pranuar ose nuk është rënë dakord të pranohen nga asnjë aksionar, mund të anulohen dhe kapitali themeltar zvogëlohet në përputhje me vlerën e aksioneve të anuluar.
3. Në pajtim me Ligjin, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me shumicën e kualifikuar të votave të përcaktuara në fjalinë e dytë të paragrafit të parë të këtij neni.

Neni 14 **Organet e shoqërisë**

1. Organet e shoqërisë së Ujësjetllës Kanalizime Malesi e Madhe sh.a., janë:
 - a) Asambleja e Përgjithshme;
 - b) Këshilli i Administrimit;

Neni 15 **Asambleja e Përgjithshme (AP)**

1. Asambleja e Përgjithshme përfaqësohet nga kryetari i Bashkisë Shkodër, i cili merr vendime brenda kompetencave të parashikuara nga ligji për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore.
2. Asambleja e Përgjithshme mbledhet në selinë e shoqërisë. Ajo thirret nga kryetari i AP-së, Këshilli i Administrimit, administratori i shoqërisë. Ajo mund të thirret, gjithashtu, nga:
 - a) eksperti kontabël i autorizuar;
 - b) nga një mandatmbajtës, i caktuar nga gjykata, me kërkesën e çdo personi të autorizuar për një rast urgjent;
 - c) me kërkesë të aksionarit të vetëm të shoqërisë.
3. Asambleja e Përgjithshme thirret në mbledhje të paktën një herë në vit, brenda 6 muajve që pasojnë mbylljen e vitit financiar.
4. Thirrja e asamblese behet me ane të njoftimit me shkresë ose nepermjet postës elektronike që i dërgohet aksionareve së bashku me rendin e dites, jo më vonë se 15 ditë përpara datës së parashikuar të mbledhjes. Njoftimi duhet të mbaje, oren dhe vendin e mbledhjes, natyrën e Asamblese, dhe rendin e dites.
5. Çdo vendim i marrë nga asambleja e përgjithshme që thirret në mënyrë të pa rregullt është absolutisht i pa vlefshëm. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas procedurës së kësaj dispozite, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë anëtarët janë të pranishëm dhe shprehen dakord për të marrë vendime pavarësisht parregullsisë.

Neni 16 **Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme**

1. Asambleja e Përgjithshme ka këto kompetenca:
 - a) Përcakton politikat tregtare të shoqërisë, si dhe miraton planin e biznesit të hartuar nga Këshilli i Administrimit të shoqërisë, i cili duhet të përputhet me kontratën për menaxhimin e shërbimit të furnizimit me ujë e kanalizimeve dhe treguesit të punës, për të cilët është rënë dakord midis palëve kontraktore;



- b) Miraton pasqyrat financiare dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë;
- c) Miraton projektplanin tarifor që propozohet për miratim në Entin Rregullator të Ujit;
- d) Emëron dhe shkarkon ekspertët kontabël të autorizuar;
- e) Emëron dhe shkarkon administratoren e shoqërisë.
- f) Miraton strukturën e organizimit dhe rregulloren e brendshme.
- g) Vendos për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- h) Çdo kompetencë tjetër që parashikohet të ushtrojë Asambleja e Përgjithshme në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar dhe në statut.
- i) Asambleja e Përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e Këshillit të Administrimit dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.
- j) Asambleja e Përgjithshme merr vendime në lidhje me akt-marëveshjet me palë të treta, në të cilat mund realizojë shërbime në të mirë të komunitetit apo të institucioneve.

Neni 17

Kryetari dhe sekretari i Asamblesë së Përgjithshme

1. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme drejtohen nga kryetari i bashkisë përkatëse.
2. Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme asistohet nga një sekretar i emëruar nga AP-ja, i cili është përgjegjës për mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve, si dhe për detyrat e tjera asistuese që i ngarkon kryetari i AP-së.
3. Në procesverbalin e çështjeve të shqyrtuara në mbledhjen e AP-së jepen data dhe vendi i mbledhjes, mënyra e thirrjes, rendi i ditës, emrat e drejtuesit e të sekretarit të AP-së, kuorumi i arritur dhe numri i aksioneve me të cilat është votuar, dokumentet dhe raportet e shqyrtuara në mbledhjen e AP-së, një përmbledhje e diskutimeve, teksti i vendimeve të kaluara për votim dhe rezultati i votimit. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë pjesëmarrësit e AP-së në mbledhje, si dhe nga sekretari.

Neni 18

Rendi i ditës i Asamblesë së Përgjithshme

1. Rendi i ditës i mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme përcaktohet nga personi apo organi i cili ka kërkuar mbledhjen e asamblesë sipas pikës 2 të nenit 15.
2. Në rast se mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme nuk realizohet, rendi i ditës i mbledhjes së saj nuk mund të ndryshohet në lajmërimin për mbledhjen e dytë.

Neni 19

Kuorumi dhe marrja e vendimeve

1. Nëse shoqëria zotërohet nga një aksionar të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga aksionari i vetëm.
2. Të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet e mëposhtme:
 - a) Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b) Shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;

- c) Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
- d) Vendimet për investime;
- e) Riorganizimi i shoqërisë.

Neni 20 **Këshilli i Administrimit (KA)**

1. Këshilli i Administrimit është organi i vetëm që ushtron funksione administrimi dhe mbikëqyrje të veprimtarisë së shoqërisë.
2. Kohëzgjatja e funksionit të Këshillit të Administrimit është 3 vjet. Mandati i KA-së ndërpritet në rast konstatimi të mospërmbushjes së objektivave të vendosur në kontratën e performancës midis AP-së dhe anëtarëve të KA-së, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Nëse një ose disa vende të anëtarëve të Këshillit të Administrimit mbeten vakant, për shkak vdekjeje, shkarkimi ose dorëheqjeje, zëvendësimi duhet të kryhet jo më vonë se 3 (tre) muaj nga data e mbetjes vakant të vendit. Anëtari i Këshillit të Administrimit i emëruar në zëvendësim të një anëtari tjetër përfundon mandatin e paraardhësit.
4. Anëtarët e Këshillit të Administrimit nuk mund të bëjnë pjesë në më shumë se 1 (një) Këshill Administrimi të shoqërive aksionare që e kanë selinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
5. Këshilli i Administrimit zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një kryetar dhe një zëvendëskryetar, të cilët thërrasin mbledhjen e Këshillit dhe drejtojnë diskutimet. Ata ushtrojnë këtë funksion për të gjithë kohën e mandatit të tyre dhe janë të rizgjedhshëm. Këshilli i Administrimit mund të emërojë një sekretar jashtë anëtarëve të tij dhe i cakton atij dhe pagën, sipas legjislacionit në fuqi.
6. Në rast mungese të kryetarit, mbledhjet e Këshillit të Administrimit drejtohen nga zëvendëskryetari.

Neni 21 **Përbërja e Këshillit të Administrimit**


1. Anëtarët e Këshillit Administrimit janë persona fizikë të cilët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një mandat 3-vjeçar dhe mund të rizgjidhen. Ata duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - a) Të jenë me profesion inxhinierë të fushës, ekonomist ose jurist.
 - b) Të kenë të paktën eksperiencë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet në fusha të njëjta ose të përafërta me objektin e veprimtarisë së shoqërisë.Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këtë nen është absolutisht i pavlefshëm.
2. Këshilli Administrimit përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, 1 (një) prej të cilëve është administratori dhe 2 (dy) janë persona të cilët nuk janë të punësuar në shoqëri. Administrator dhe anetar i keshillit te administrimit eshte z. Flauers Shoshi i pajisur me Nr. karten e identitetit I20210179I. Anetar i keshillit te administrimit eshte zj. Sabahete Harlicaj e pajisur me Nr. karte identiteti G45710057V, dhe znj. Enkeleda Smakaj e pajisur me Nr. Karte identiteti J25822086G .
3. Anëtarët e Këshillit të Administrimit në momentin e emërimit lidhin me shoqërinë një kontratë pune, në të cilën janë parashikuar, ndër të tjera, kritere të qarta performance që pritet të arrijë anëtari i Këshillit të Administrimit në terma vjetorë. Objektivat për performancën (indiktorët) e vendosur në këtë kontratë duhet të miratohen edhe nga ministria e linjës dhe duhet të jenë të matshëm dhe në përputhje me biznesplanet e shoqërisë.

4. Në rastin e vendeve vakante, që krijohen me vdekjen apo dorëheqjen e një apo disa anëtarëve të Këshillit të Administrimit, kur numri i anëtarëve të këtij këshilli ka zbritur nën minimumin ligjor, administratorët duhet të thërrasin urgjentisht mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme për të plotësuar numrin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit.

Neni 22

Kompetencat e Këshillit të Administrimit

1. Këshilli i Administrimit ushtron, njëko-hësisht, funksione administrimi e mbikë-qyrjeje të veprimtarisë së shoqërisë dhe i jep administratorit autorizimin për kryerjen e veprimeve që nuk mund të kryhen prej tij pa autorizimin e Këshillit të Administrimit.
2. Këshilli i Administrimit ka të drejtë të kryejë në çdo kohë verifikime dhe kontrole që ai i çmon të përshtatshme dhe të njihet me dokumentacionin që e gjykon të nevojshëm për përbushjen e detyrës së tij.
3. Këshilli i administrimit ka këto të drejta dhe përgjegjësi:
 - a) Të japë direktiva për administratorin për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) Të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratori;
 - c) Të gjykojë paraprakisht biznesplanin e shoqërisë, të paraqitur nga administratori. Ky dokument duhet të miratohet e të nënshkruhet nga të gjithë e anëtarët e Këshillit të Administrimit për t'iu paraqitur Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
 - d) Të përgatitë, me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;
 - e) Të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
 - f) Të respektojë standardet e kontabilitetit;
 - g) Të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
 - h) Të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratori. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Administrimit për t'iu paraqitur Asamblesë së Përgjithshme, së bashku me një raport të Këshillit të Administrimit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;
 - i) Të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur, dhe raporti i auditimit, drejtuar Asamblesë së Përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të Këshillit të Administratorëve. Raporti i Këshillit të Administrimit, përmendur në shkronjën "ë" të kësaj pike, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;
 - j) Të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;
 - k) Të miratojë paraprakisht biznesplanin e paraqitur nga administratori dhe t'ia paraqesë për miratim përfundimtar Asamblesë së Përgjithshme.
4. Këshilli i Administrimit ka të drejtë t'i propozojë Asamblesë së Përgjithshme:
 - a. Përcaktimin dhe ndryshimin e programit të veprimtarisë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë të shoqërisë;

- 
- b. Treguesit e performancës që duhet të arrijë shoqëria në fund të vitit fiskal, si element bazë i vlerësimit të punës së administratorëve të shoqërisë;
 - c. Kryerjen e investimeve dhe financimeve për vitin financiar, si dhe masat e tjera që do të kërkonin ndryshimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
 - d. Marrjen e huave afatmesme e afatgjata;
 - e. Për çdo çështje tjetër që në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 23

Mbledhja dhe vendimet e Këshillit të Administrimit

1. Këshilli i Administrimit mblidhet jo më pak se një herë në muaj dhe sa herë e kërkon interesi i shoqërisë aksionare, me thirrjen e kryetarit.
2. Kryetari duhet të thërrasë mbledhjen e Këshillit të Administrimit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita kur administratori ose 2 (dy) prej anëtarëve të Këshillit të Administrimit i paraqesin atij një kërkesë të motivuar për këtë qëllim.
3. Nëse kërkesa mbetet pa përgjigje, atëherë anëtarët kërkues mund të thërrasin Këshillin e Administrimit duke i përcaktuar rendin e ditës.
4. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes bëhet me shkrim jo më vonë se 3 (tre) ditë përpara mbledhjes dhe dërgohet me postë ose në rrugë elektronike.
5. Çdo thirrje për mbledhjen e Këshillit të Administrimit duhet të përmbajë çështjet kryesore të rendit të ditës. Mbledhja e Këshillit të Administrimit zhvillohet në selinë e shoqërisë ose në çdo vend tjetër të treguar në thirrjen e bërë për këtë qëllim.
6. Këshilli i Administrimit mban një regjistër të pjesëmarrjes në mbledhje, i cili nënshkruhet në çdo mbledhje nga anëtarët e Këshillit të pranishëm në atë mbledhje.
7. Vendimet e Këshillit të Administrimit pasqyrohen në procesverbalet e mbajtura gjatë mbledhjes nga sekretari i Këshillit të Administrimit, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
8. Vendimet e Këshillit të Administrimit duhet të nënshkruhen nga anëtarët pjesëmarrës në mbledhje. Kopjet e këtyre procesverbaleve vërtetohen nga kryetari dhe sekretari.

Neni 24

Shkarkimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit

1. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë KA-në ose një anëtar të saj, duke vërtetuar mospërbushjen e objektivave të vendosur në kontratën midis palëve, me shumicë të thjeshtë votash.

Neni 25

Përfundimi i mandatit të anëtarëve të Këshillit të Administrimit

1. Mandati i anëtarëve të Këshillit të Administrimit përfundon në rastet e mëposhtme:
 - a) Me mbarimin e mandatit të administratorit.
 - b) Me konstatimin e atyre rrethanave të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e ushtrimit të mandatit të tyre.

dhe certifikimit të stafit menaxhial dhe operacional të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, subjekti të paraqesë vërtetim nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën për pamundësinë objektive për pajisjen me këtë certifikatë. Në çdo rast, administratori paraqet certifikatën sapo certifikimi të jetë bërë i mundur. Konstatimi i mospajisjes me certifikatën përkatëse të kualifikimit përbën shkak për shkarkimin e tij.

2. Drejtori teknik ka këto kompetenca:

- a. Bën studimin dhe hartimin e projekteve të nevojshme për furnizimin me ujë të konsumatorëve të veçantë ose zonave të banuara.
- b. Bën përditësimin e rrjetit të furnizimit me ujë e të kanalizimeve të ujërave të ndotura.
- c. Është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe kontrollin e rrjetit shpërndarës.
- d. Administron dhe mirëmban gjithë rrjetin e tubacioneve, kolektorët kryesorë, pusetat e shkarkimit të ujërave të ndotura dhe pajisjet që shërbejnë për largimin e ujërave të ndotura që vijnë kryesisht nga banesat (ujëra të ndotura dhe industriale).
- e. Është përgjegjës për sigurimin e furnizimit me ujë të pijshëm sasior dhe cilësor në zonën e shërbimit sipas standardeve në fuqi dhe garantimin e një sistemi teknikisht të përshtatshëm për furnizimin me ujë që nga burimet deri te konsumatori.
- f. Garanton largimin efikas të ujërave të ndotura me anë të një sistemi të përshtatshëm të rrjetit të kanalizimeve dhe trajtimin e tij në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura.
- g. Çdo detyrë të caktuar në kontratën e punës me Drejtorin e Përgjithshëm.

Neni 28

Kriteret e përzgjedhjes dhe kompetencat e drejtorit tregtar

1. Drejtori tregtar zgjidhet nga administratori (Drejtori i Përgjithshëm) sipas kriterëve minimale:

- a) Të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë "Mastershkencor", në shkencat ekonomike, në degët financë/administrim biznesi.
- b) Të zotërojë certifikata përkatëse për aftësimin specifik profesional të tij, sipas detyrës që do të ushtrojë.
- c) Drejtori tregtar ka këto kompetenca:
- d) Siguron mbarëvajtjen dhe zbatimin e procedurave ligjore për të gjithë veprimtarinë ekonomike-financiare të shoqërisë.
- e) Siguron zbatimin e praktikave e të procedurave ligjore dhe nënligjore të cilat mbrojnë asetet e shoqërisë dhe administron burimet financiare të saj.
- f) Harton planbuxhetin për vitin pasardhës dhe planet financiare strategjike për shoqërinë, të cilat i paraqet për miratim pranë administratorit ekzekutiv.
- g) Është përgjegjës dhe nënshkruan pasqyrat financiare vjetore individuale dhe të konsoliduara, si dhe raportin e administrimit, dokumente të cilat ia paraqet për miratim paraprak administratorit ekzekutiv. Administratori ekzekutiv i paraqet Këshillit të Administrimit për miratim të gjitha pasqyrat financiare vjetore, raportin e administrimit, si dhe propozimet për caktimin e fitimit.
- h) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë.
- i) Ushtron kontrolle periodikë mbiveprimtarinë ekonomike-financiare të ndjekur nga specialistët përkatës.
- j) Garanton ruajtjen e standardeve të kontrollit të brendshëm financiar dhe zbatimin e standardeve të kontrollit financiar të specifikuara nga Ministria e Financave.

- MAJASIE
- c) Harton strukturën e organizimit dhe rregulloren e brendshme të veprimtarisë së shoqërisë në mbikqyrje të Këshillit Administrimit dhe propozojnë për miratim në Asamblenë e Përgjithshme. Struktura e organizimit të shoqërisë duhet të ketë patjetër një drejtori/departament teknik dhe një drejtori/departament tregtar, drejtuesit e të cilave zgjidhen nga administratori (Drejtori i Përgjithshëm) sipas neneve 28 dhe 29, të këtij statuti.
 - d) I paraqet Këshillit të Administrimit një raport një herë në muaj për ecurinë e shoqërisë. Brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar, administratori duhet t'i paraqesë Këshillit të Administrimit llogaritë vjetore me qëllim verifikimi dhe kontrolli.
 - e) Përfaqëson dhe vepron në emër të shoqërisë në marrëdhëniet me palë të treta dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e veprimtarisë së saj.
 - f) Paraqet çdo vit përpara Asamblesë së Përgjithshme raportin e veprimtarisë së shoqërisë.
 - g) Raporton përpara Këshillit të Administrimit për zbatimin e politikave tregtare dhe për realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë.
 - h) Lidh kontrata në emër të shoqërisë pas dhënies së mendimit edhe të dy drejtorëve të tjerë.
 - i) Siguron bashkëpunimin me institucionet publike dhe personat juridikë vendas apo të huaj në të mirë dhe interes të veprimtarisë së shoqërisë.
 - j) Nxjerr urdhra dhe udhëzime të brendshëm të detyrueshëm për menaxhimin administrativ e financiar të shoqërisë.
 - k) Organizon e bashkërendon punën ndërmjet sektorëve në përbërje funksionale të shoqërisë.
 - l) Krijon një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë.
 - m) Kryen regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, dhe ligjeve të tjera në fuqi.
 - n) I paraqet propozime dhe sugjerime Këshillit të Administrimit, në të mirë dhe interes të veprimtarisë së shoqërisë, sa herë që i kërkohet ose me nismën e vet.
 - o) Siguron zbatimin e vendimeve të Këshillit të Administrimit.
 - p) Drejton veprimtarinë e shoqërisë, zgjedh dhe mbikëqyr personelin e saj, përfshirë punësimin, administrimin, kualifikimin e personelit dhe masat disiplinore, në përputhje me ligjin, statutin e shoqërisë dhe rregullat e miratuara nga Këshilli i Administrimit.

Neni 27

Kriteret e përzgjedhjes dhe kompetencat e drejtorit teknik

1. Drejtori teknik zgjidhet nga administratori (Drejtori i Përgjithshëm) sipas kriterëve minimale:
 - a) Të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë "Master shkencor", në shkencat inxhinierike, në degët inxhinierihidroteknike, mjedisi, ndërtimi, biokimike, mekanike apo disiplina të ngjashme,
 - b) Të ketë përvojë pune jo më pak se 3 vjet. Në rastet kur operatori ushtron veprimtari për përpunimin e ujërave për konsum publik apo për përpunimin e ujërave të ndotura, duhet të ketë edhe një drejtues të dytë teknik, të kualifikuar me diplomë universitare në degët inxhinieri hidroteknike, mjedisi, ndërtimi, biokimike, mekanike apo disiplina të ngjashme.
 - c) Të zotërojë certifikatën përkatëse për aftësimin specifik profesional të tij, sipas detyrës që do të ushtrojë, në fushën e menaxhimit të ujësjellës-kanalizimeve-trajtimin e ujërave të ndotura. Në rast se në momentin e emërimit të tij nuk ka përfunduar ende procesi i trajnimit



Neni 26

Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit

1. Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit do të caktohet nga Asambleja e Përgjithshme, sipas dispozitave përkatëse ligjore apo nënligjore dhe mbulohet nga shoqëria.
2. Shoqëria njih, gjitashtu, dhe shpenzimet e bëra nga anëtarë të Këshillit të Administrimit, kur këta të fundit dërgohen me shërbim nga vetë Këshilli i Administrimit për probleme të shoqërisë.

Neni 27

Administratori i shoqërisë

1. Administratori i shoqërisë është person fizik, i cili zgjidhet si i tillë për shkak të funksionit në shoqëri, në të kundërt emërimi i tij është i pavlefshëm. Ai kryen administrimin e përditshëm të shoqërisë. Për t'u zgjedhur administrator, personi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
 - a) Të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë "Master shkencor", në shkencat inxhinierike, ekonomike, juridike apo në fushën e administrimit të biznesit, sipas profilit që do të emërohet.
 - b) Të zotërojë certifikatën përkatëse për aftësimin specifik profesional të tij, sipas detyrës që do të ushtrojë, në fushën e menaxhimit të ujësjellës-kanalizimeve e të trajtimit të ujërave të ndotura. Në rast se në momentin e emërimit të tij, nuk ka përfunduar ende procesin e trajnimit dhe i certifikimit të stafit menaxherial dhe operacionaltëshoqërivetëujësjellës-kanalizimeve, subjekti të paraqesë vërtetim nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën për pamundësinë objektive për pajisjen me këtë certifikatë. Në çdo rast, administratori paraqet certifikatën sapo certifikimi të jetë bërë i mundur. Konstatimi i mospajisjes me certifikatën përkatëse të kualifikimit përbën shkak për shkarkimin e tij.
 - c) Të ketë eksperiencë pune si drejtues apo administrator në sektorin publik apo privat, si dhe rezultate pozitive të punës, të vërtetuar me referenca nga punëdhënësit e mëparshëm.
2. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me dispozitën e mësipërme është absolutisht i pavlefshëm.
3. Një person nuk mund të emërohet administrator në më shumë se një shoqëri.
4. Administratori emërohet për një periudhë kohe prej 3 (tre) vjetësh, por në bazë kontratash të rinovueshme vjetore. Rinovimi i kontratave midis Asamblesë dhe administratorit do të jetë vjetor në bazë vlerësimesh pozitive të performancës së punës. Numri i mandateve është i pakufizuar. Administratori i shoqërisë është Z. Flauers Shoshi i pajisur me kartën e identitetit me numer I202101791.
5. Paga e administratorit caktohet nga Asambleja e Përgjithshme në aktin e emërimit të tij. Asambleja e Përgjithshme propozon shtim të pagës apo shpërblime për administratorin sipas kriterëve të performancës në kontratën e punës së lidhur ndërmjet tij dhe administratorit.
6. Administratori Ekzekutiv ka këto kompetenca:
 - a) Menaxhon dhe është përgjegjës për aktivitetin e shoqërisë nëpërmjet zbatimit të politikave e të planeve të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme.
 - b) Harton planbizneset e shoqërisë dhe i paraqet në Këshillin Administrimit.

- k) Siguron zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë.
- l) Siguron zbatimin e sistemit financiar dhe të faturim/arkëtimit të shoqërisë.
- m) Çdo detyrë të caktuar në kontratën e punës me drejtorin e Përgjithshëm.

Neni 29

Detyrimi i besnikërisë

1. Përveç sa parashikohet në dispozitat e këtij statuti, administratorët detyrohen:
 - a) Të kryejë detyrat e tyre, të përcaktuara në ligj ose në statut, në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë;
 - b) Të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut, vetëm për arritjen e qëllimeve, të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) Të vlerësojnë në mënyrë të përshtatshme çështjet për të cilat merret vendim;
 - d) Të parandalojnë dhe të mënjanojnë rastet e konfliktit, të pranishme apo të mundshme, të interesave personale me ato të shoqërisë;
 - e) Të ushtrojnë detyrat e tyre me profesio-nalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim gjatë kryerjes së detyrave të tyre, me përjashtim të rasteve kur veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim, në bazë të hetimit e vlerësimit të mjaftueshëm të informacioneve dhe lidhet, në mënyrë të arsyeshme, me qëllimet e shoqërisë tregtare.
3. Administratorët, që veprojnë në kundër-shtim me detyrat dhe shkelin standardet e kujdesit, të përmendura në pikat 1 e 2, të këtij neni, janë të detyruar t'i shpërblejnë shoqërisë dëmet që rrjedhin nga shkeljet, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.

Neni 30

Shkarkimi i administratorit

1. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin me shumicë të thjeshtë votash në rast të konstatimit të mospëmbushjes së objektivave të kontratës midis palëve.
2. Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë shkarkimin e administratorit brenda 15 ditëve nga data e marrjes së njoftimit nga një institucion shtetëror për shkarkimin e tij, si rezultat i një detyrimi ligjor/zyrtar.

Neni 31

Përfundimi i mandatit të administratorit

1. Mandati i administratorit të shoqërisë përfundon me konstatimin e atyre rrethanave të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e ushtrimit të mandatit të tij.

Neni 32

Ekspertët kontabël të autorizuar

1. Kontrolli i shoqërisë ushtrohet nga ekspertë kontabël të autorizuar, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme dhe kryejnë misionin e tyre në pajtim me ligjin. Ekspert kontabël i shoqërisë është Zj. Eftali Qirjaqi e pajisur me kartën e identitetit F95101116B dhe licensën me numer 11 date 10.02.2000.

Neni 33

Ushtrimi kontabël

1. Ushtrimi kontabël fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.

Neni 34

Inventari - llogaritë vjetore

1. Mbajtja e kontabilitetit dhe paraqitja e pasqyrave financiare vjetore bëhet në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar.
2. Në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, shoqëria i harton pasqyrat financiare vjetore në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar.
3. Administratori përgatit, në datën e pasqyrave financiare, raportin e administrimit për gjendjen dhe performancën e shoqërisë gjatë ushtrimit kontabël.

Neni 35

Rezultati i ushtrimit dhe përcaktimi i fitimit

1. Fitimi i tatueshëm përcaktohet sipas dispozitave të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar.
2. Nga fitimi pas tatimit, i realizuar gjatë vitit financiar paraardhës, duke zbritur shpenzimet, shoqëria duhet të kalojë në rezervën ligjore, të paktën 5 për qind të kësaj vlere, derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me 10 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
3. Për fitimet e akumuluar nga shoqëria, pas arritjes së rezervës 10 për qind, aksionerët mund të vendosin, sipas ligjit, për një destinim të ndryshëm të fitimit të pashpëndarë.

Neni 36

Procedura e bashkimit të shoqërisë me operatorë të tjerë

1. Shoqëria aksionare mund të bashkohet me operatorë të tjerë vetëm në rastet kur nga ana e shoqërive të plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - a) Të jetë të licencuar nga Enti Rregullator i Ujit.
 - b) Të ketë vlerësuar dhe përditësuar inventarin e aseteve e të likuiditeteve të tyre.
 - c) Të jetë miratuar me vendim përkatës të Këshillit Bashkiak.

Neni 37
Likuidimi i shoqërisë

1. Likuidimi i shoqërisë të bëhet sipas mënyrës dhe formës të përcaktuar me ligj.

Neni 38
Dispozita të kalimtare

1. Për sa nuk është parashikuar në statut, rregullimi i modaliteteve të tjera që lidhen me funksionimin e shoqërisë të bëhet sipas dispozitave të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.
2. Ky statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 39
Zgjidhja e mosmarreshjeve

1. Te gjitha mosmarreshjet gjate funksionimit te shoqerise ose gjate likuidimit te saj qe lindin midis shoqerise dhe Aksionerit ose midis vete Aksionereve, lidhur me veprimtarine e Shoqerise, i nenshtrohen juridiksionit te gjykatave kompetente ne kushtet e parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Neni 40

1. Ky statut së bashku me ndryshimet dhe të gjitha dokumentet, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhëna nga Shoqëria do të publikohet nga Administratorët në faqen e internetit të Shoqërisë nëseka.
2. Ky Statut hartohet ne gjuhen shqipe, ne kater kopje me vlere te njejte.

KRYETARI I ASAMBLESE

TONIN MARINAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALËSI E MADHE
UJËSJELLËSI MALËSI E MADHE SH.A
KËSHILLI ADMINISTRIMIT**

Nr. 426/prot

Koplik,më: 18/06 /2018

V E N D I M

Nr. 78/1 Datë 18/06 /2018

**PËR
SHKARKIMIN E "KRYETARIT" TË KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT TË SH.A
UJËSJELLËS MALËSI E MADHE**

Në mbështetje të ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore",si dhe në mbështetje të ligjit nr 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare" të ndryshuar ,VKM – NR 63 DATË 27.01.2018 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm ,grumbullimin,largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura " ,Statutit të Ndërmarrjes Sh.A Ujësjiellës Malësi e Madhe ,pika 5,ligji nr 8102 datë 28.03.1996"Për kuadrin rregullator të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura" si dhe bazuar Vendimin nr 18 datë 29.06.2016 të Këshillit Bashkiak.

V E N D O S A

1. Shkarkimin e Kryetares së Këshillit të Administrimit Znj.Enkeleda Smakaj me nr.ID J25822086G
2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

TONIN MARINAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALËSI E MADHE
UJËSJELLËSI KANALIZIME MALËSI E MADHE SH.A**

Nr. 6924 prot

Koplik, më: 30/10/2018

V E N D I M

Nr. 127 Datë 30/10 2018

**PËR
EMËRIMIN E “KRYETARIT ” TË KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT TË SH.A
UJËSJELLËS MALËSI E MADHE**


Në mbështetje të ligjit nr 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare” të ndryshuar ,VKM – NR 63 DATË 27.01.2018 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm ,grumbullimin,largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura ” ,Statutit të Ndërmarrjes Sh.A Ujësjiellës Malësi e Madhe ,pika 5,ligji nr 8102 datë 28.03.1996”Për kuadrin rregullator të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” referuar statutit të Ndërmarrjes .

V E N D O S A

1. Emërimin e Znj.Rexhina Rrjoli me nr ID **I25506068K** si Kryetare Këshillit të administrimit .
2. Kryetari thërret mbledhjen e Këshillit dhe drejton diskutimet .
3. Këto funksione ushtrohen gjatë gjithë mandatit, kryetari është i rizgjidhshëm.
4. Çdo funksion i mëparshëm i ngjashëm shfuqizohet.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME

TONIN MARINAJ



Adresa:Koplik-Qender

tel:021122650/2651

e-mail:bashkiamalesimadhe@hotmail.com